



Datë: 1 Korrik 2026

TERMA REFERENCE

Për angazhimin e një eksperti/eje për hartimin e një Dokumenti Politikash (Policy Paper) mbi Rreziqet e Korrupsionit dhe Aksesin e Grave Rome në Shërbimet Publike

Organizata	Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri
Adresa:	Rr. "Nikolla Tupe", P. 2/4, Ap. 15, Tiranë, Shqipëri.
E-mail:	genderjusticealbania@gmail.com
Pozicioni i shërbimit të kërkuar:	Ekspert për hartimin e një Dokumenti Politikash
Lloji i kontratës:	Kontratë Shërbimi
Periudha e kontraktimit:	15 Korrik – 15 Gusht 2026
Data e mundshme e fillimit të shërbimit:	15 Korrik 2026
Zona gjeografike:	Shqipëri
Afati i dorëzimit të aplikimit:	11/07/2026

1. HYRJE

Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri (QDGJSH) është një organizatë jofitimprurëse, e pavarur, jo-politike, e cila punon për fuqizimin e grave dhe vajzave, mbrojtjen e drejtave të tyre dhe lufton pabarazitë gjinore. QDGJSH është regjistruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë më datë 28/06/2022 me vendimin nr. 1738. Sipas legjislacionit në fuqi, QDGJSH është regjistruar gjithashtu pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, Tiranë me nr. NIPT: M22002451K.

Misioni i Qendrës është të kontribuojë për krijimin e një shoqërie ku të gjitha gratë të jetojnë një jetë me dinjitet, pa diskriminim dhe me mundësi të barabarta.

Qasja e Qendrës për Drejtësi Gjinore në Shqipëri, është:

- Të punojë për parandalimin e dhunës me bazë gjinore, rritjen e nivelit të informimit dhe ndërgjegjësimin të shoqërisë shqiptare rreth të drejtave të grave dhe çështjeve gjinore;
- Të mbështesë gratë dhe vajzat për të rritur pjesëmarrjen dhe influencën e tyre në jetën sociale, ekonomike dhe politike të vendit nëpërmjet zbatimit të programeve të lidershit, rritjes së aftësive profesionale, etj.;



Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri

- Të adresojë nevojat e grave dhe vajzave viktime të dhunës me bazë gjinore, përfshirë dhunën në familje, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve direkte me qëllim fuqizimin e tyre social dhe ekonomik;
- Të rrisë kapacitetet e punonjësve të institucioneve shtetërore dhe jo-shtetërore që punojnë për mbrojtjen dhe ofrimin e shërbimeve për gra dhe vajza;
- Të avokojë për respektimin e të drejtave të grave dhe arritjen e drejtësisë gjinore në shoqërinë shqiptare;
- Të kryejë studime, analiza dhe kërkime rreth çështjeve gjinore, përfshirë dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje.

2. INFORMACION MBI SHËRBIMIN E KËRKUAR

Qendra për Drejtësi Gjinore po zbaton projektin: **“Fuqizimi i zërit të grave dhe vajzave Rome për të adresuar dhe raportuar korrupsionin në Bashkinë Tiranë”** në partneritet me Institutin e Kulturës Rome në Shqipëri.

Në kuadër të projektit, **kërkohet të kontraktohet një ekspert për hartimin e një Dokumenti Politikash (Policy Paper) mbi rreziqet e korrupsionit dhe aksesin e grave Rome në shërbimet publike.**

Qëllimi i këtij angazhimi është hartimi i një Dokumenti Politikash që:

- analizon format dhe faktorët që favorizojnë korrupsionin në ofrimin e shërbimeve publike për gratë Rome;
- identifikon pengesat ligjore, institucionale dhe administrative që ndikojnë në aksesin e tyre;
- analizon ndikimin e korrupsionit në ushtrimin e të drejtave themelore;
- ofron rekomandime konkrete dhe të zbatueshme për institucionet publike në nivel qendror dhe vendor.

3. KOHËZGJATJA E SHËRBIMIT

Shërbimi do të ofrohet gjatë periudhës 15 Korrik – 15 Gusht 2026 dhe do të konsistojë në **10 ditë pune.**

4. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË KRYESORE TË EKSPERTIT

Eksperti/ja do të jetë përgjegjës/e për:

4.1. Analizën dokumentare

- Shqyrtimin e legjislacionit shqiptar në fushën e: luftës kundër korrupsionit; administratës publike; barazisë gjinore; mbrojtjes nga diskriminimi; mbrojtjes së minoriteteve; ofrimit të shërbimeve publike.
- Shqyrtimin e strategjive dhe planeve kombëtare përkatëse.
- Analizën e raporteve të institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Shqyrtimin e studimeve dhe kërkimeve ekzistuese mbi komunitetin rom dhe aksesin në shërbime publike.

4.2. Analizën e situatës

Eksperti/ja do të analizojë:

- format më të zakonshme të korrupsionit që ndikojnë gratë Rome;
- rreziqet dhe dobësitë institucionale;
- faktorët socialë dhe ekonomikë që rrisin ekspozimin ndaj korrupsionit;
- ndikimin e diskriminimit ndërsektorial (gjinor dhe etnik);
- sfidat në aksesimin e shërbimeve publike.

4.3. Hartimin e Dokumentit të Politikave

Dokumenti duhet të përfshijë të paktën kapitujt vijues:

- Përmbledhje Ekzekutive;
- Hyrje;
- Metodologjia;
- Konteksti;
- Analiza ligjore dhe institucionale;
- Analiza e rreziqeve të korrupsionit;
- Analiza gjinore;
- Gjetjet kryesore;
- Rekomandime politike;
- Përfundime.

5. PRODUKTET E PRITSHME

Eksperti/ja duhet të dorëzojë:

Produkti 1

Drafti i parë i Dokumentit të Politikave i cili duhet të përmbajë:

- analizën dokumentare;
- analizën ligjore;
- gjetjet;
- rekomandimet paraprake.

Produkti 2

Versioni përfundimtar i Dokumentit të Politikave. Dokumenti duhet të jetë i redaktuar profesionalisht dhe gati për publikim.

Gjatësia e pritshme: **15–20 faqe**.

Afatet e sakta do të përcaktohen në kontratë.

Të gjitha produktet do të dorëzohen në format elektronik (Word dhe PDF).



6. KUALIFIKIME DHE AFTËSI TË KERKUARA

- Diplomë universitare (preferohet në drejtësi apo shkenca sociale);
- Master shkencor apo profesional (preferohet në drejtësi apo shkenca sociale);
- Zotërimi i njohurive shumë të mira të çështjeve gjinore, të demokratizimit, promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut;
- Eksperienca të mëparshme pune për realizimin e studimeve, analizave, raporteve me fokus në çështjet gjinore apo demokratizimin;
- Eksperienca të mëparshme pune me organizata të shoqërisë civile;
- Zotërimi i aftësive shumë të mira komunikuese;
- Bashkëpunimi me qasje pozitive dhe etikë profesionale.

7. PROCESI I APLIKIMIT

Aplikantët e interesuar duhet të dërgojnë me shkrim në adresën elektronike ose adresën postare të Qendrës për Drejtësi Gjinore dokumentacionin e poshtëshënuar:

- Curriculum Vitae;
- Letër motivimi;
- Ofertë financiare për shërbimin e kërkuar në monedhën LEK.

Adresë elektronike: genderjusticealbania@gmail.com; a.vangjeli@gjalbania.org

Adresë postare: Rr. "Nikolla Tupe", P. 2/4, Ap. 15, Tiranë, Shqipëri.

8. AFATET

Afati për dërgimin e aplikimeve: 11/07/2026, ora 17:00